



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.09.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 3(2), 16, 17, 18(1 dhe 2) korrik 2018.
2. Diskutimi dhe miratimi i projektkalendarit të punës së komisionit për muajin shtator.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Fate Velaj, Adelina Rista, Fadil Nasufi, Ismet Beqiraj, Bujar Çela, Almira Xhembulla.

Mungojnë:

Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Nora Malaj, Kejdi Mehmetaj, Shezai Rrokaj.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi – Mirëdita të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e parë të komisionit për këtë sesion. Në fakt, mbledhja e sotme është e thjeshtë. Ajo zhvillohet pa prezencën e opozitës, e cila ka vendosur të bëjë një aktivitet tjetër dhe të braktisë komisionet. Mendoj se do të ishte mirë që ata të ishin këtu, sepse, në fakt, çështjet që janë për t'u diskutuar janë të rëndësishme, i shërbejnë popullsisë, njerëzve në nevojë dhe për këtë gjë duhet vëmendja e tyre në të gjitha reformat dhe politikat që ndërmarrim ne, si parlament. Megjithatë, ata e dinë vetë se si duhet të veprojnë.

Ne sot jemi mbledhur për të vendosur për kalendarin e punimeve për këtë periudhë të Sesionit të tretë, të Legjislaturës IX të Kuvendit. Fillojmë duke pasur parasysh që në Kuvend janë depozituar disa projektligje nga qeveria, që kanë nevojë për diskutimin, konsultimin dhe gjykimin tonë. Përveç kësaj, ju e dini që ne kemi qenë dhe jemi një komision që bëjmë aktivitet parlamentar intensiv. Në fakt, për këtë gjë duhet falenderuar edhe opozita, e cila ka qenë shumë kërkuese për kalendarin e dëgjësive parlamentare. Sot duhet të shikojmë me kujdes ato projektligje që janë depozituar nga Këshilli i Ministrave për t'u diskutuar në seancat plenare.

Në mbledhjen e sotme kemi dy çështje për të diskutuar: miratimin e procesverbaleve të muajit korrik dhe miratimin e kalendarit për javët në vijim. Besoj se keni pasur mjaftueshëm kohë për t'u hedhur një sy procesverbaleve të mbledhjeve të datave 3, 16, 17 dhe 18 korrik. Ka ndonjëri nga ju ndonjë vërejtje apo t'i miratojmë së bashku procesverbalet? I keni lexuar?

Ismet Beqiraj – Edhe unë u uroj suksese komisioneve për fillimin e punimeve të Sesionit të tretë të Kuvendit. Sigurisht, shpreh keqardhje për mospjesëmarrjen e opozitës, por, pavarësisht aktiviteteve të tyre të planifikuara, mendoj se atyre nuk ju kanë mjaftuar pushimet njëmuajore dhe po i vazhdojnë akoma ato. Kjo është çështje e tyre, por elektorati dhe njerëzit presin zgjedhjen e halleve dhe problemeve që janë kudo në Shqipëri, për zgjidhjen e të cilave kontributi i opozitës është i pazëvendësueshëm.

Për sa u përket procesverbaleve, sugjeroj që para se të miratohen duhet të bëhen redaktimet përkatëse. Unë u hodha një sy dhe pashë që kishin nevojë për redaktim jo vetëm në gabime ortografike, por edhe në shprehje. Janë dokumente që do të ngelin pjesë e historisë së

veprimtarisë së komisioneve dhe arkivit, dhe që nesër, pasnesër studiuesit e ndryshëm do t'i kërkojnë. Ndonjë lapsus që ne deputetët bëjmë, duhet të korrigjohet nëpërmjet redaktimit. Këtë sugjerim kam.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Përgjithësisht zbardhet ajo që ne flasim, kështu që edhe ne duhet të bëjmë kujdes kur flasim, ta kemi mendimin të njëtrajtshëm dhe të mos bëjmë lapsuse.

Herë tjetër duhet ta shikoni edhe vetë, që të bëni redaktimin tuaj personal, nëse gjeni ndonjë gjë që nuk shkon te procesverballi. Ndonjëherë, edhe në zbardhje mund të bëhet ndonjë gabim i lehtë. Gjithsesi, unë i kam parë dhe mendoj se procesverbalet janë në rregull. Si mendoni, t'i votojmë sot procesverbalet?

Dakord, miratohen.

Çështja e dytë e rendit të ditës ka të bëjë me diskutimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe KFW Frankfurt am Main, për financimin e programit të rehabilitimit të konvikteve të Universitetit të Tiranës sipas parimit të eficiencës së energjisë, faza II”. Ne kemi diskutuar edhe një herë tjetër në këtë komision për fazën e parë, kështu që unë mendoj se duke qenë që jemi komision për dhënie mendimi, mund të propozojmë tani se kë duam të thërrasim në dëgjese dhe të përcaktojmë një datë për t'u mbledhur si komision për të dhënë mendim mbi projektligjin.

Kini parasysh që në kalendarin e veprimtarisë së Kuvendit që miratuam, ky projektligj diskutohet në seancën e datës 20 shtator në Kuvend. Kështu që për ne data 18 është dita e fundit që mund të japim mendim për këtë projektligj. Unë propozoj që në dëgjesën për këtë projektligj të thërrasim Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe atë të Infrastrukturës, kurse data e zhvillimit të dëgjësës për këtë projektligj të jetë data 18, ora 10.00. Nuk e di nëse ju keni propozime të tjera

Ismet Beqiraj – Unë propozoj që për këtë projektligj të thërrasim Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës, e cila ka të bëjë me eficiencën e energjisë, përfaqësues nga rektorati i Universitetit të Tiranës dhe sidomos nga drejtoria e “Qytetit Studenti”.

Milva Ekonomi – Ajo varet nga bashkia. Ju thoni që duhet të ketë edhe një përfaqësues nga bashkia?

Ismet Beqiraj – Patjetër, sepse bashkia është ajo që bën zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

Milva Ekonomi – Dakord, do të thërrasim edhe një përfaqësues nga bashkia.

Një tjetër gjë e rëndësishme është që ne duhet të caktojmë edhe relatorin. Vilma propozon që relatori që ka qenë herën e parë të vazhdojë edhe me relatimin e këtij projektligji,

që është faza e dytë. I lutem sekretarisë të shikojë se kush ka qenë relator te miratimi i projektligjit për fazën e parë dhe të na sugjerojë emrin, për ta pasur relator për pjesën e dytë.

Kemi për të vendosur edhe disa çështje të tjera në kalendar, që lidhen me aktivitete të kërkuara, por jo të përfunduara, nga sesioni i kaluar, si dhe me disa ushtrime të kontrollit tonë parlamentar që janë bërë tashmë, si të thuash, rutinë.

Zakonisht, kur fillon viti i ri shkollor, sistemi arsimor parauniversitar, ne e kemi zakon të bëjmë një dëgjese me ministren e Arsimit. Edhe nga diskutimet që kemi bërë bashkë, propozoj të bëjmë një dëgjese me ministren e Arsimit.

Gjithashtu, ka qenë diçka e rëndësishme edhe ajo që kemi diskutuar herët e kaluara, që të marrim në konsideratë edhe arsimin profesional. Kemi kërkuar të bëjmë një diskutim me Ministrinë e Ekonomisë për arsimin profesional. Mbase edhe kjo do të jetë një çështje tjetër në kalendarin e punimeve për këtë periudhë.

Një gjë tjetër e rëndësishme lidhet me Inspektoratin e Punës, për kërkesën që kemi bërë për kontratat e gazetarëve, ku ata do të bënin një mbikëqyrje në terren se si ishte situata e kontratave të gazetarëve. Dëgjuesin me Inspektoratin e Punës për situatën e kontratave të gazetarëve është mirë ta vendosim në këtë kalendar që do të miratojmë.

Përveç kësaj, hedh për propozim edhe të tjera aktivitete, që lidhen me çfarë kemi bërë edhe në sesionin e kaluar, si vizita në disa *site*, që i takojnë mbulimit të veprimtarisë së komisionit tonë. Për shembull, të ndërmarrim një vizitë në RTSH, ku po ndodh një digjitalizim i rëndësishëm. I kemi premtuar vetes të shkojmë dhe të shikojmë se si po riorganizohet puna në RTSH. Besoj se duhet ta vendosim në kalendar.

Kemi edhe situatën drejt digjitalizimit me AMA-n. I kemi ndjekur këto ditë problemet që ka pasur nga kalimi analog në digjital për transmetimet lokalet në shtrirjen gjeografike Tiranë dhe Durrës. Ju e patë vendimin që mori AMA për ta spostuar afatin e pajisjes me dekodera.

Në fakt, mendoj se kjo është një përgjegjësi institucionale për ente të pavarura, që veprojnë drejt, kur ka një situatë akses jo të plotë të qytetarëve për të qenë të pajisur me dekodera, por ndërkohë duhet ta diskutojmë edhe me AMA-n se çfarë do të bëjë ajo për ta çuar deri në fund këtë detyrë që mori. Kështu që propozoj edhe një takim në ambientet e AMA-s.

Nuk e di, si ju duken këto propozime? Unë jua thashë në bllok, por janë detyra të lëna, që edhe ne si komision të jemi më aktivë, për sa i takon veprimtarisë sonë parlamentare.

Keni ndonjë propozim të ri?

Kalendari do të bëhet me data. Do të diskutohet edhe me pjesën tjetër, që nuk është sot prezente në komision. Datat fikse do t'ju vijnë me *e-mail*.

Duhet të falënderojmë sekretarinë, që gjithmonë është e gatshme të përgjigjet në kohë shumë të shpejtë për të gjitha ngarkesat që marrim përsipër!

Ju, keni propozim tjetër përveç këtij blloku propozimesh?

Pra, kemi një takim të martën, ndërkohë të tjera takime do të vijnë, pasi të diskutohen datat me pjesën tjetër të komisionit.

Po, Fadil.

Fadil Nasufi – Jam dakord me propozimet tuaja, e nderuara nënkryetare.

Besoj se në agjendë duhet të vihet edhe plotësimi i vendeve vakante në Këshillin Drejtues të RTSH-së, sepse kanë kaluar afatet e kandidaturave, për vendet që janë vakante që në muajin qershor.

Këto vizita, siç i propozuat ju, tek institucioni i AMA-s, te RTSH-ja, duhet të pasurohen edhe me vizita të tjera në qendra kulturore për çështje të trashëgimisë, në funksion të një agjende, që ndoshta mund të konsultohet edhe me Ministrinë e Kulturës. Pastaj, sipas një praktike dhe një përvoje që ka sidomos Komisioni i Veprimtarive Prodhuese, që bën një kombinacion midis problematikave të procedurave që na vijnë për miratim në komision dhe në parlament, të njihemi edhe në terren me shumë vlera. Ne i thërrasim aktorët këtu, por duke shkuar atje, shikojmë realisht se si është gjendja.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit shumë!

Jam shumë dakord. Ky është një aktivitet që duhet të kryhet nga ne, por në bashkëpunim edhe me pjesën tjetër të komisionit, me përfaqësues të Partisë Demokratike dhe të LSI-së. Kështu që do ta shtojmë edhe këtë në kalendar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne nuk e bëjmë dot pa ata, as ata nuk punojnë dot pa ne. Kështu që duhet të biem dakord të bashkëpunojmë për këtë çështje. Keni shumë të drejtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Duke parë edhe shënimet e herës së kaluar, besoj se relator për këtë çështje do të jetë zoti Ismet Beqiraj.

Të kemi dhënë një detyrë, relator për këtë projektligj.

Faleminderit!

Ka çështje të tjera për të diskutuar?

Mund ta konsiderojmë këtë mbledhje si të suksesshme dhe ta mbyllim?

Shpresojmë që mbledhjen e ardhshme të kemi prezencën e kolegëve tanë të opozitës! Është më e bukur mbledhja kur janë edhe ata.

Kush është dakord për kalendarin? Të gjithë janë dakord.
Faleminderit shumë!

MBYLLET MBLEDHJA